



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____/____/202__

PËR

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË ALOKUAR NGA BUXHETI I SHTETIT
NË ZBATIM TË VKM NR. 483, DATË 02.09.2025, “PËR DHËNIE SHPËRBLIMI
PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN
E ZJARREVE GJATË VITIT 2025”**

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. Nr 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, Vendimit nr.483, datë 02.09.2025 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5,208,000 (pesëmilion e dyqind e tetë mijë) lekë të alokuar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës sektoriale në zbatim të VKM-së nr. 483 dt. 02.09.2025, “Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”, sipas tabelës së mëposhtme:

Kodi institucionit	Emri institucionit	Gr.	Kapitulli	Programi	Kodi projektit	Llogaria ekonomike	Vlera (në lekë)
2107001	Bashkia Durrës (MZSH)	00	01	03280	90001AA	600	5,208,000

2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e MZSH për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

GRUPI PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK NË BASHKINË Durrës

Emiriana	Sako	Kryetar	Kryetar i Bashkisë
Gentian	Kallmi	Anëtar	Zv/Kryetar i Bashkisë
Elio	Jani	Anëtar	Zv/Kryetar i Bashkisë
Egert	Hoxha	Anëtar	Zv/Kryetar i Bashkisë
Almiva	Llaçi	Anëtar	Dr. Kabineti
Ina	Ferra	Anëtar	Dr. Dr. Ekonomike
Valbona	Qiriako	Anëtar	Dr. Dr. Buxhetit
Alncida	Rroshi	Anëtar	Dr. Dr. Ligjore
Roni	Shqiopa	Anëtar	Dr. DTTV
Ardian	Iljazaj	Anëtar	Dr. Dr. Shërbimeve
Alda	Zyferi	Anëtar	Dr. Dr. Projekt dhe Infr. Publike
Lorenc	Smajli	Anëtar	Dr. Dr. Turizmit
Ana	Hoxha	Anëtar	Dr. Dr. Planif. Zhvill. Kontr. Territorit
Migena	Muhaj	Anëtar	Dr. Dr. AKRSKE
Diola	Xhango	Anëtar	Dr. Dr. Shërbimit Social
Brunilda	Gripshi	Anëtar	Dr. Dr. Burimeve Njerëzore
Oneda	Deliallisi	Anëtar	Dr. Dr. Auditit të Brendshëm
Xhulio	Llazo	Anëtar	Dr. Dr. Informatikës dhe Dixhitalizimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË ALOKUAR NGA BUXHETI I SHTETIT NË
ZBATIM TË VKM NR. 483, DATË 02.09.2025, "PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT
TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN
E ZJARREVE GJATË VITIT 2025"

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. Nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", i ndryshuar, Vendimit nr.483, datë 02.09.2025 të Këshillit të Ministrave "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025" Bashkisë Durrës i është alokuar fondi prej 5,208,000 lekë.

Ky fond është alokuar me shkresën nr. 14505/11 prot. datë 24.10.2025 të Ministrisë së Financave në strukturën buxhetore si më poshtë:

Funksionet e financuara me transferte sektoriale	Grupi	Kapitulli	Llogaria ekonomike	Programi	Kodi projektit	Vlera (në lekë)
Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi	00	01	604	03280	90001AA	5,208,000

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 483 dt. 02.09.2025 punonjësit e angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025 do të përfitojnë një shpërblim si më poshtë vijon:

- Për angazhim në kohëzgjatje, nga 1 (një) deri në 7 (shtatë) ditë, jepet shpërblim në masën 1 (një) pagë mujore
- Për angazhim me kohëzgjatje, nga 8 (tetë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, jepet shpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore
- Për angazhim me kohëzgjatje, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë e më shumë jepet shpërblim në masën e 3 (tri) pagave mujore

Në total punonjësit zjarrëfikës përfitues janë 52, nga të cilët:

- 2 punonjës do të marrin shpërblim në masën e 1 (një) page mujore
- 4 punonjës do të marrin shpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore
- 46 punonjës do të marrin shpërblim në masën e 3 (tri) pagave mujore

Fondi total për shpërblimin është në vlerën 9,840,000 lekë dhe do të financohet në masën 5,208,000 lekë nga fondit i ardhur nga buxheti i shtetit për këtë qëllim dhe diferenca prej 4,632,000 lekë do të financohet

nga transfertat sektoriale e alokuar për vitin 2025, për programin 03280 "Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile", llogaria 600 (paga).

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë:

1. Shpërndarjen e fondit të alokuar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës sektoriale në zbatim të VKM-së nr. 483 dt. 02.09.2025, sipas tabelës së mëposhtme:

Kodi institucionit	Emri institucionit	Gr.	Kapitulli	Programi	Kodi projektit	Llogaria ekonomike	Vlera (në lekë)
2107001	Bashkia Durrës (MZSH)	00	01	03280	90001AA	600	5,208,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e MZSH.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

GRUPI PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK NË BASHKINË DURRËS

Emiriana	Sako	Kryetar	Kryetar i Bashkisë
Gentian	Kallmi	Anëtar	Zv/Kryetar i Bashkisë
Elio	Jani	Anëtar	Zv/Kryetar i Bashkisë
Egert	Hoxha	Anëtar	Zv/Kryetar i Bashkisë
Almiva	Llaçi	Anëtar	Dr. Kabineti
Ina	Ferra	Anëtar	Dr. Dr. Ekonomike
Valbona	Qiriako	Anëtar	Dr. Dr. Buxhetit
Alneida	Rroshi	Anëtar	Dr. Dr. Ligjore
Roni	Shqiopa	Anëtar	Dr. DTTV
Ardian	Iljazaj	Anëtar	Dr. Dr. Shërbimeve
Alda	Zyferi	Anëtar	Dr. Dr. Projekt. dhe Infr. Publike
Lorenc	Smajli	Anëtar	Dr. Dr. Turizmit
Ana	Hoxha	Anëtar	Dr. Dr. Planif. Zhvill. Kontr. Territorit
Migena	Muhaj	Anëtar	Dr. Dr. AKRSKF
Diola	Xhango	Anëtar	Dr. Dr. Shërbimit Social
Brunilda	Gripshi	Anëtar	Dr. Dr. Burimeve Njerëzore
Oneda	Deliallisi	Anëtar	Dr. Dr. Auditit të Brendshëm
Xhulio	Llazo	Anëtar	Dr. Dr. Informatikës dhe Dixhitalizimit